

“MANUALI I PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN VENDIMARRËS TË KUVENDIT”

Takim Konsultimi me organizata të shoqërisë civile

11 shkurt 2021

- **Çështje të përgjithshme të identifikuara dhe rekomandime mbi to**

- Regjistrimi tek portali i konsultimit të Kuvendit lejon komente si individ por jo si organizatë
- Është e nevojshme që përditësimi i manualit të bëhet duke marrë parasysh edhe ndryshime që kanë ndodhur gjatë viteve të fundit në rregulloren e Kuvendit
- (Duke pasur parasysh faktin që parlamenti aktual së shpejti shpërndahet) Procesi i konsultimit të këtij Manuali dhe përditësimit të tij duhet të jetë sa më i plotë sidomos me shoqërinë civile dhe të mos nxitohet me miratimin e tij gjatë kësaj legjislature (të pritët konstituimi i Kuvendit pas zgjedhjeve)
- Faqja e re e Kuvendit duhet të shoqërohet me kapacitete më të plotë për të rritur transparencën. Specifikisht procesverbalet e mbledhjeve të fundit të komisioneve parlamentare zbardhen me vonesë dhe ne si shoqëri civile nuk kemi mundësi të reagojmë në kohë për procese të ndryshme vendimmarrëse në Kuvend. Shembuj ilustrativë janë marrëveshjet e fundit të ratifikuara në kuvend për vaksinat apo zgjatjen e koncesionit të Rinasit të cilat nuk janë publike në faqen e parlamentit.
- Ka një praktikë shqetësuese që Kuvendi nuk fton shoqërinë civile për ligje me rëndësi ose ligjer për të cilat ka një ndjeshmëri publike si psh ndryshimet e fundit në kodin zgjedhor apo në Kushtetutë, aktet lidhur me situatën e COVID etj.
- Të sigurohet implementimi i rekomandimit për dërgimin e feedback / përgjigje për pranimin ose jo të propozimeve dhe sugjerimeve të dërguara nga publiku (Shih ‘Detyrat e koordinitorit’)
- Të bëhen publike nismat ose informacioni mbi peticione dërguar Kuvendit dhe të informohen nismëtarët lidhur me statusin e nismes / peticionit të tyre

- Në disa seksione të manualit sugjerohet Sekretari i përgjithshëm i Kuvendit si pika kryesore e kontaktit dhe vendimmarrëse për çështje relativisht të thjeshta të cilat nuk kanë nevojë të jenë kaq shumë të centralizuara. Ky është rasti psh për aksesin e publikut në arkivën e kuvendit, vizita në grupe në kuvend, pjesëmarrjen në kuvend etj. Të shihet mundësia për decentralizimin dhe thjeshtëzimin e procedurave për pjesëmarrjen e publikut dhe aksesit në informacion parlamentar.
- Zyrrat lokale të deputetëve nuk janë funksionale dhe mund të shihen si një instrument shtesë për perfshirjen e publikut
- Të merret parasysh mundësia për krijimin e një regjistri online të peticioneve (disa njësi vendore e kanë aplikuar me sukses tashmë)
- **Terminologjia e përdorur**
 - *përkufizimi i publikut* - mungon tek përkufizimet, e derisa është një manual që I referohet pjesëmarrjes së publikut do duhet të kishte një përkufizim se kujt I referohet me “publik”.
 - *Termi qytetar* nuk përmendet thuajse fare. Duhet të kemi parasysh se Kushtetuta I njeh të drejtën edhe individit / qytetarit të thejshëm për të përfshirë në [veprimtarinë e kuvendit dhe këtë gjë manuali duhet ta reflektojë në tërësi.
 - *terminologjia e përdorur për përkufizimin e grupimit “Shoqëri civile”*, duhet riparë. Mbase duhet marrë tjetër referencë, më relevante se sa ajo ekzistuese.
 - *Termi “partner social”*, është një tjetër rast ku mungon tërësisht referenca shpjeguese se çfarë nënkuptohet me termin partner social dhe kush cilësohet apo klasifikohet si I tillë?

- **Regjistri elektronik i shoqërisë civile**

Ky regjistër cilësohet nga Manuali si element kyç për identifikimin e organizatave të shoqërisë civile dhe si mjet lidhës e komunikues me Kuvendin. Manuali përmend se baza e të dhënave për këtë regjistër është sistemi I integruar tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ku sipas Manualit janë të regjistruara të gjitha organizatat e shoqërisë civile që janë aktive. Janë disa çështje që duhen rishikuar si pjesë e kësaj pike:

- Aktualisht, regjistrimi në faqen e Kuvendit të Shqipërisë bëhet me vullnetin e organizatave dhe jo nga të dhënat e tatimeve. Nëse do të ishte nga tatimet do ishte shumë më i madh se sa ai ekzistues.
- Të dhënat e DPT, nuk tregojnë për grupimet e aktivistëve, grupe interesi etj. të cilat nuk janë të regjistruar në tatime.
- Për të qenë korrekt me terminologjinë, duhet të jetë regjistër i organizatave jofitimprurëse/organizatave të shoqërisë civile. Sektori është shumë më i gjerë se sa kaq dhe përfshin edhe si më lart.
- **Njoftimi i palëve për seancat dëgjimore në komisione**
 - *njoftimi për pjesëmarrje në konsultim është i mbyllur dhe i kufizuar* - sipas Manualit kryetari, në bashkëpunim me zëvendëskryetarin dhe sekretarin e komisionit, janë personat përgjegjës për përcaktimin e listës së organizatave të shoqërisë civile, ekspertët, grupet e interesit etj të cilëve do t'u dërgohet ftesa/ njoftimi për pjesëmarrje në seancë dëgjimore. Kjo mënyrë mund të jetë forma jo e duhur, sepse vendimi nga ana e tyre mund të jetë subjektiv, të lidhet me njohje, parapëlqime, ose edhe në rastet kur nuk ka fare interesa specifike pas përzgjedhjes së njërës OJF apo tjetrës, mund të lidhet me një informacion që mund të jetë i kufizuar nga ana e personave si më lart. Përzgjedhja duhet të bëhet bazuar në terma të qartë, bazuar në meritokraci, aktivizëm e përfaqësim, profesionalizëm, të jetë publike e në këtë rast mund të përfshihen të gjithë të interesuarit për çështjet.
 - *Mungesa e përcaktimit të afateve kohore* - jo vetëm në rastin e njoftimit paraprak ku nuk ka asnjë përcaktim kohor për afatin e dërgimit të rekomandimeve nga palët e interesuara mbi dokumentet për konsultim, duke krijuar hapsirë për ndarje të dokumenteve në afate të pamjaftueshme/pamundura për dhënien e feedback-ut. Gjithsesi, *afatet kohore* mungojnë dhe për dërgimin e kthim përgjigjes në rast kërkesë për seancë dëgjimore nga palët e interesuara por edhe në pjesë të tjera.
- **Informimi i shoqërisë civile për rekomandimet e bëra**

Në lidhje me rekomandimet e organizatave të shoqërisë civile dhe marrjen në konsideratë të tyre, Manuali përcakton se "*Në raportin përfundimtar të Komisionit mbi projektligjin duhet të përfshihet dhe një përmbledhje e rekomandimeve të shoqërisë civile që janë marrë në konsideratë*"- Si pjesë e raportit (anexx) ose në hapësira të tjera të faqes së Kuvendit duhet të përfshihen të gjitha rekomandimet e dhëna (sic I kanë sjellë propozuesit ose të grumbulluara)

mundësisht bashkë me argumentin e komisionit për rekomandimet e pa marra në konsideratë duke qënë kështu transparent për cdo arsyetim dhe vendimmarrje kundrejt rekomandimeve të ardhura. Për më tepër, është një gjë me vlerë sepse për gjithë projektligjet e paraqitura ose konsultimet e bëra, do ketë rekorde të propozimeve nga grupet e interesit dhe OJFtë për t'ju referuar edhe më vonë e jo vetëm si pjesë e procesit aktual.

- **Shprehja e interesit nga palët e interesuara të publikut për pjesëmarrje në seancat dëgjimore të komisioneve**

Për thjeshtësimin e kësaj procedure mund të ketë formate të gatshme për aplikim me të gjithë elementët që jepen në këtë sesion. Këto formate mund të përpilohen edhe për sesione/cështje të tjera ku përmenden kërkesat dhe cfarë duhet të përmbajë kërkesa.

- **Raporti vjetor për bashkëpunimin me Shoqërinë Civile dhe Konferenca vjetore për çështje të bashkëpunimit me Shoqërinë Civile**

Manuali përcakton se Kuvendi i Shqipërisë në bashkëpunim me organizatat dhe përfaqësues të shoqërisë civile publikon një raport vjetor. Ky raport është një raport i Kuvendit kundrejt përmbushjes së detyrimeve të tij ligjore për një vendimmarrje konsultuese gjithëpërfshirëse, dhe si i tillë duhet të hartohet nga Kuvendi. Është tjetër gjë që mund ti dëgohet për mendim OSHCve nëse duan të shtojnë diçka nga ajo se cfarë OSHCtë kanë bërë, dërguar e bashkëpunuar me kuvendin, por raporti është I kuvendit dhe hartohet prej tij.

Të dhënat e raportit vjetor mbi konsultimet e kryera përfshijnë jo vetëm konsultime me aktorë jo shtetërore (OJF, grupe interesi etj.) por edhe me institucione dhe agjensi shtetërore dhe kjo shkon përtej bashkëpunimit me shoqërinë civile (çka është tema e raportit përkatës)

Raporti duhet të përfshirë jo vetëm bashkëpunime e rekomandime të marra parasysh, por edhe peticione, kërkesa për dëgjesa etj që nuk janë marrë parasysh.